

DEKLARATA

Rrjetit të të Drejtave Digjitale për Europën Juglindore

Fondacioni SHARE dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, BIRN, shohin nevojën për krijimin e Rrjetit të të Drejtave Digjitale për Europën Juglindore, në mënyrë që të luftojë përdorimin në rritje dhe në zhvillim të shpejtë të teknologjive të përparuara dhe të adresojë shqetësimet për mbrojtjen e të dhënave dhe shkeljet në internet.

Kjo përpjekje vjen në një moment kur ne po shohim ndërhyrje në rritje nga aktorë shtetërorë dhe komercialë që kontribuojnë në hapësirën tashmë në tkurrje për debat, ndërsa ushtrimi i të drejtave themelore të njeriut vazhdimisht po kufizohet. Teknologjia e avancuar po përdoret jo vetëm për të përmirësuar jetën e qytetarëve, por për të kontrolluar shoqërinë, veçanërisht organizatat dhe individët e zëshëm në kritikën e tyre për përkeqësimin e demokracisë.

Gjatë pandemisë COVID-19, përmes monitorimit tonë kemi parë shumë raste të shkeljeve të të drejtave digjitale në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Në demokracitë tashmë të brishta dhe joliberalë, kufizimi i të drejtave të njeriut shihet edhe në mjedisin digjital në formën e kërcënimeve. Mungesa e ndërgjegjësimit për këto çështje brenda shoqërisë dëmton më tej demokracinë, jo vetëm në kohë krize.

Për më tepër, pasojat e këtyre trendeve dhe tendencave negative do të vazhdojnë të ndikojnë rëndë në privatësinë e individëve duke përhapur frikë, veçanërisht midis grupeve të marginalizuara, gjë që në mënyrë të pashmangshme çon në frenime të lirive dhe të drejtave të garantuara dhe rrit rrezikun e shfrytëzimit dhe dhunës, e cila mund të transferohet lehtësisht në jetën reale.

Prandaj, ne ju ftojmë të bashkoheni në koalicionin tonë të organizatave të shoqërisë civile, media dhe individë që dëshirojnë të kontribuojnë me aftësitë e tyre, njohuritë dhe përvojën për të arritur ato që ne i shohim si synime të përbashkëta, kryesisht duke përmirësuar demokracitë tona dhe pozicionin e individëve në mjedisin digjital.

Rrjeti i propozuar synon të mbledhë aktorë përkatës që aktualisht punojnë në çështjet e abuzimeve me të drejtat digjitale, mungesën e transparencës dhe përdorimin e zgjeruar të zgjidhjeve teknologjike invazive në Europën Juglindore shpesh në kurriz të privatësisë. Ky rrjet do të shërbejë si një platformë për dialog konstruktiv midis anëtarëve të saj dhe diskutim të frytshëm për zgjidhje, shembuj praktikash të mira, idesh dhe sugjerimesh të reja. Rrjeti i të Drejtave Digjitale për Europën Juglindore do të punojë në mënyrë proaktive dhe do të nxjerrë deklaratë publike që adresojnë problemet ekzistuese dhe ato në zhvillim me qëllim parandalimin e pasojave negative.

Ndërkohë që ushqen vlerat e sigurisë, barazisë dhe lirisë, puna e Rrjetit të të Drejtave Digjitale për Europën Juglindore do të drejtohet në arritjen e qëllimeve të mëposhtme:

- Të mbrojnë të drejtat digjitale dhe liritë në internet
- T'i mundësojë njerëzve qasjen në informacione të sakta
- Ta bëjnë internetin një vend më të sigurt
- Të zbulojë dhe raportojë gjuhën e urrejtjes dhe dhunën verbale në internet, veçanërisht kundër grave dhe grupeve të tjera të cenueshme
- Të identifikojë rekrutimin në internet, i cili mund të çojë në shfrytëzim
- Të marrë kontrollin e të dhënave personale
- Të ndalojë zbatimin e sistemeve mbikëqyrëse invazive
- T'i mbajë qeveritë përgjegjëse për përdorimin dhe abuzimin e teknologjisë
- Të kërkojë mbrojtje në çdo kohë të të drejtave bazike të njeriut, përfshirë edhe në kohë krize
- Të ndajë njohuri dhe eksperiencë dhe të ndërtojë një rrjet
- Të përmirësojë aftësinë e përdorimit të internetit me qëllim parandalimin e dhunës dhe shfrytëzimit

Rrjeti do të synojë të rrisë nivelin e të kuptuarit të tendencave dhe praktikave komplekse dhe shqetësuese, duke u përpjekur t'i afrojë ato më pranë publikut të gjerë në një gjuhë që ai mund ta kuptojë. Duke krijuar një hapësirë të përbashkët për diskutim dhe shkëmbim mendimesh, organizatat dhe mediat do të jenë në gjendje të rrisin impaktin e përpjekjeve të tyre individuale të drejtuara drejt ndryshimeve legjislative, politike dhe sociale. Arritja e palët e interesuara dhe ndërgjegjësimi duke përdorur autoritetin e të gjithë anëtarëve të Rrjetit do t'i japin nismave tona të përbashkëta ndikim dhe rezonancë më të madhe.

Ne e shohim evolucionin digjital si një grup mekanizmesh dhe mjetesh që kanë potencial të madh për t'i shërbyer nevojave të njerëzve, ndërsa qasja në internet është vërtetuar e domosdoshme në kohë krizash siç është pandemia e COVID-19. Shoqëritë tona po bëhen gjithnjë e më digjitale, gjë që paraqet një shtysë të fuqishme për të rritur aftësinë e organizatave që merren me zhvillimet dhe rregulloret digjitale në Europën Juglindore.

Në epokën digjitale në të cilën jetojmë, një sërë sfidash të shumta kërkojnë veprime më të koordinuara dhe të përbashkëta, sidomos duke marrë parasysh që:

- Liria jonë e të shprehurit po kontrollohet nga algoritmi
- Komunikimi ynë virtual shpesh formësohet nga algoritme që promovojnë gjuhë urrejtjeje dhe shkatërrim
- Ligjërimet tona po kontaminohen me manipulime dhe dezinformim

- Shoqëritë tona po formësohen nga nivele të dobëta edukimi digjital
- Shoqëria jonë është edhe më e brishtë në hapësirën digjitale
- Të dhënat tona biometrike, fytyrat tona, janë subjekt i një survejimi masiv
- Jetët tona po dehumanizohen duke u bërë më sasiore në të dhëna dhe duke u shitur për fitim
- Qeveritë tona po përdorin teknologjinë për të ushtruar kontroll mbi shoqërinë dhe për të grumbulluar pushtet
- Demokracitë e brishta po bëjnë regres në kohë krize
- Komunitetet tona nuk po punojnë së bashku për të adresuar këto çështje
- Besimi ynë në institucionet që duhet të na mbrojnë po bie në mënyrë të ndjeshme

Rrjeti do të jetë unik në larminë e anëtarëve të tij, duke i bashkuar ata rreth një përkushtimi të përbashkët për mbrojtjen e vlerave dhe parimeve themelore njerëzore si në internet ashtu edhe jashtë tij. Respektimi i të drejtave të njeriut, siguria dhe siguria e të dhënave personale dhe përdorimi i përgjegjshëm i teknologjive me zhvillim të shpejtë do të jenë thelbi i parimeve udhëzuese të Rrjetit.